



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



01 Nr. 295/24 Dt. 10.05.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**Procesverbali nga mbajtja e konsultimit publik me qytetarë për
Plotësimin-Ndryshimin e Rregullores për Përdorimin e Gjuhëve ne
Komunën e Prizrenit**

Konsultimi publik me qytetarë është organizuar nga grupi punues për hartimin e Plotësim-Ndryshimin e Rregullores për Përdorimin e Gjuhëve ne Komunën e Prizrenit.

Njoftimet për qytetarë për organizimin e konsultimit publik janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **17.04.2024** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/04/Njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-Plotesimin-Ndryshimin-e-Rregullores-per-perdorimin-e-gjuheve_compressed-1.pdf

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/LnXLhxnhjDLSvxK/?mibextid=oFDknk>

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42358>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-plotesimin-ndryshimin-e-rregullores-per-perdorimin-e-gjuheve-ne-komunen-e-prizrenit/>

Konsultimi është mbajtur në sallën e kuvendit komunal (Shtëpia e Bardh) dhe ka filluar në orën 10:15

Haziz Krasniqi, zyrtar i larte për informim

Të nderuar të pranishëm, të nderuar media.

Sikurse edhe dokumente tjera dhe këtë dokument, kryetari i komunës ka nxjerr vendim për formimin e grupit punues për plotësimin dhe ndryshimin e projekt rregullores me numër 01, 011, 3, 32, 50 të datës 08. 03, 2012 për përdorimin e gjuhëve zyrtare në komunën e Prizrenit.

Ky grup punues e ka bërë plotësim ndryshimin e kësaj rregullore dhe kjo rregullore është në konsultim publik nga data 17.04.2004 deri më datën 02.05.2024. Komentet, sugjerimet dhe vërejtjet eventuale mund ti dërgoni në email-in zyrtare të [blerim.rakaj @rks-gov.net](mailto:blerim.rakaj@rks-gov.net) , fatmirmenekshe@gmail.com dhe tek unë haziz.krasniqi@rks-gov.net.

Ne këtë konsultim publik do të mbahet procesverbal, sigurisht që edhe raportin ne kuadër të raportit a do të përfshihen të gjitha komentet të cilët ju sot i jepni. Sigurisht që komentet që vijnë edhe në formë fizike, gjithashtu edhe në formë elektronike, ne do ti përfshijmë në raportin final, sikurse edhe në dokumente të tjera përgjigjet për secilin koment. Varësisht qysh e kemi marrë qoftë në gjatë konsultimit publik, dokument fizik ose dhe përmes formës elektronike do ti merrni në kuadër të raportit. Atëherë, fjalën do ta merre dhe Fatmir Menekshe, anëtar i grupit punues.

Fatmir Menekshe – OJQ “DURMISH ASLANO” dhe anëtare i grupit punues për hartimin e rregullores

Mirëdita të gjithëve.

Ju falënderoj të gathëve që i jeni përgjigjur ftesës për këtë konsultim publik lidhur me Rregulloren e Gjuhëve apo përdorimin e gjuhëve në komunën e Prizrenit. Duhet gjithsesi falënderuar gjithë organizatave dhe aktivistëve që kanë marr pjesë në fazën apo rundin e dytë të avokimit, ku bashkë me ta kemi arritur një sukses për herë të parë para dy vjetëve, kur kemi arritur që gjuha rome të njihet si gjuhë në përdorim zyrtar në komunën e Prizrenit.

Tani është faza e dytë kur po arrijmë që ta ndryshojmë Rregulloren për Përdorimin e Gjuhëve, të intervenojmë në nenin i cili do i jep përparësi gjuhës rome për përdorim. Duhet falënderuar edhe organizatën Voice of Roma, Ashkali and Egyptians, organizatë e cila na ka përkrahur në fazën e dytë, ndërsa Këshilli i Evropës në fazën e parë, dhe organizatat “Durmish Aslano”; “Nevo Koncepti” dhe “Romtegra” të cilët po e ngrisin aktivizimin çdo ditë në aspektin politik dhe ndryshim-plotësimi i kësaj Rregulloreje është një prej sukseseve të arritura të këtij grupi. Normalisht, dehet falënderuar edhe Komunën e Prizrenit, kryetarin Shaqir Totaj, dhe gjithë ekzekutivin të cilët po e tregojnë vullnetin politik dhe po dëshirojnë të punojnë me komunitetin rom, me qëllim të përmirësimit të jetës së tyre, sikurse është tani, respektimi i të drejtës për gjuhë.

Ju faleminderit edhe një herë për pjesëmarrje dhe shpresoj se e gjithë kjo çfarë do të prezantohet nga grupi punues që ishin pjesëmarrës në dhënien e kontributit të tyre, si dhe në ndërhyrje të Rregullores, dhe ju ta lexoni Rregulloren, dhe nëse keni ndonjë këshillë apo kontribut që diçka duhet përmirësuar apo shtuar në këtë dokument, ju lutëm merrni fjalën. Konsultimi është i hapur deri me datën 2 (dy), dhe besoj se deri në takimin e ardhshëm në Kuvend do të bëhet edhe votimi i kësaj Rregulloreje.

I falënderoj edhe një herë mediat, organizatat, Zyrën për Komunitete që ka dhënë propozimet dhe gjithë akterët që kanë treguar aktivizmin e tyre përmes nënshkrimit të kërkesave që i kemi bërë. Edhe një herë ju faleminderit.

Naim Kukaj, zyrtar ligjore dhe anëtarë i grupit punues për hartimin e rregullores

Të nderuar, siç ju tha dhe kryesuesi dhe anëtari i grupit punues, ne kemi pasur një mandat nga ana e kryetarit komunës për me be plotësim ndryshimin e rregullores 2012. Gjithmonë duke u bazuar në vendimin e asamblesë komunale, kuvendit komunal që ka marrë në muajin e dhjetë të 2022-es për inkorporimin e gjuhës rome si gjuhë në përdorim zyrtar, sikur punonjësit thanë edhe kta na kemi fillu punën.

Pothuajse pa vonesë edhe kemi dalë me një draft të plotësim ndryshimit të rregullores konform vendimit të asamblesë komunale, s'kemi guxu shumë me dalë as më pak se çka e thatë asamblea, vendimi i asamblese dhe akteve nënligjore, udhëzimi administrativ dhe ligji për gjuhët.

E keni parë me siguri e keni draftin të përkthyer në gjuhën rome, e kanë kryer apo atë mundem dhe pse kemi kaq ndryshimet, e kemi bërë ndryshimin e pikës 2, kemi riformuluar prej fillimit që e kemi inkorporuar dhe gjuhën rome pasi që nuk ka qene gjuha rome në përdorim zyrtar kanë qenë vetëm gjuhët tjera.

Qysh e dini gjuha turke, boshnjake janë konceptuar, ata nuk po ju lexoj, por edhe nën 2 të rregullores. Kush e ka nuk e di komplet rregulloren. Neni 2 nuk e kemi pritur e kemi shtu neni 2 edhe kemi thonë qysh e keni parë gjuha rome.

Gjuha rome si gjuhë në përdorim zyrtar do të përdoret në mënyrë efektive konform akteve ligjore nënligjore, që i bie se aktet ligjore dhe nënligjore janë aktet ligjore në fuqi. Udhëzimi dhe ligjet nënligjor janë aktet e komunës.

Ne kemi konsideruar që rregullon mjaftueshëm bazën e përdorimit të gjuhës rome si gjuhë në përdorim zyrtar në institucione publike të komunës. Për momentin ka gjatë diskutimeve, këqyrni mori shënime dhe.

Osman Osmani – OJQ “NEVO KONCEPTI

Mirëdita. Unë jam Osman Osmani, vi nga organizata “Nevo Koncepti”. Organizata jonë, dhe njerëzit që kanë marr pjesë në takime, konsultime apo në projektin që e kemi zbatuar këto dy vjetët e fundit, qëllimi ynë ishte që gjuha jonë të njihet nga komuna jonë dhe të jetë funksionale në përdorim në komunë dhe me çështjet që ndërliken me komunitetin rom. Në fillim, dua ta

falënderoj Komunën dhe gjithë pjesëtarët e shoqërisë civile të cilët e kanë gjetur gjuhën e përbashkët, kanë dhënë përkrahjen tyre dhe arritëm që pas dy vjetësh gjuha rome të njihet si gjuhë në përdorim zyrtar në Komunën e Prizrenit.

Edhe ky procesi i cili ndërlidhet, që të jemi të përfshirë në politikën e Komunës e cila ngërthen në vete çështjen e gjuhës, komunitetit rom i është ofruar një hapësirë që mendoj se gjithçka që është e rëndësishme për informim dhe njoftim, të jetë në gjendje që të jetë në situatë të barabartë. Besoj se edhe ky ndryshim që e keni bërë në Rregullore është pozitiv. Kur i kemi bërë konsultimet për gjuhë, sidomos me Rrjetin ad-hoc dhe me gjithë njerëzit që kemi punuar, që në të gjitha rastet ku përmendet gjuha boshnjake dhe turke të përmendet edhe gjuha rome.

Jemi të vetëdijshëm që nuk kemi asambleist në Komunë, dhe e dimë që vendimi për njohjen e gjuhës rome është njohja në nivel të tretë, pra si gjuhë tradicionale. Mendoj se komuniteti rom, së bashku me Komunën do të arrijnë ta çojnë përpara këtë proces, e që po dëshmohet edhe me takimin e sotëm ku jemi një numër mjaft i madhe i komunitetit rom që jemi të interesuar, dhe me këtë pikë, pra pikën 2a, besoj që sado pak do i plotësojmë të gjitha ato kërkesa të cilat komuniteti rom tani e sa vjet po i përmend dhe mendon se janë të rëndësishme. Unë nuk kam ndonjë koment apo sugjerim.

Mendoj se edhe ky propozim i juaji nga Komisioni për mua si Osman Osmani është një rrugëtim pozitiv dhe mendoj se Komuna, shoqëria civile dhe shoqëria rome në tërësi, do të tregojnë përkushtim shumë më të madhe për të dëshmuar përkrahjen e dhënë nga Komuna në këtë çast. Besoj se do të merremi shembull edhe nga komunat tjera, sepse Komuna e Prizrenit ka treguar një hap shumë pozitiv dhe ka treguar rrugën se si duhet arritur deri këtu. Mendoj se, me këtë, në të gjitha komunat ku ka romë, do ta marrin këtë si praktikë dhe, edhe ata, do të arrijnë që ta gëzojnë të drejtën e tyre. Ju falemnderit.

Arben shala, vij prej fondacionit kosovar për shoqëri të hapur KFOS Faleminderit

Uroj që kjo të jetë një punë e mbarë po i përgjigjem pak dhe Osmanit nuk është që na duhet me falënderu komunën pse po na bën këto, arsyeja është se kjo është një e drejtë themelore, të cilën komuna e Prizrenit se pari tashmë një angazhim më të madh të shume më shumë hisedarëve ka mbërrir me jetësua.

Pra kemi të bëjmë me ushtrimin e të drejtave themelore të njeriut, sidomos komitete përdorimi i gjuhëve. Ajo se kemi mbërrir deri këtu është falë angazhimit të disa hisedarëve. Pra e kemi shoqërinë civile të përbërë prej organizatave joqeveritare të komunitetit rom, ashkali, egjiptian dhe organizatave tjera joqeveritare, shoqëria civile, agjencitë zhvillimore të tjera, organizatat ndërkombëtare të ndryshme që kanë qenë dhe me partnerë komunën.

Pra ka qenë si nevojë, jo si nevojë, por si e drejtë themelore, por me një kërkesë fillestare të organizatave qeveritare që vijnë prej komuniteteve rom, ashkali, egjiptian edhe të gjithë të tjerët kemi mbërrir deri në këtë pikë ku jemi tash.

Unë po konsideroj edhe nga organizata jonë. Prezantohen njëherë para të gjithëve. Arben shala, vij prej fondacionit kosovar për shoqëri të hapur KFOS i ose i zyrës sorosit. Mjaft, kemi qenë kemi mbërri deri në këtë pikë, mirëpo ta shohim çka më tutje personin apo konsiderojmë se kemi mbërri atë që duhet si e drejtë themelore.

Nuk kemi ku shkojmë përtej kësaj, pra karshi kësaj rregullore që përmenda dhe etni tjera ku përfshihet dhe komuniteti rom dhe përdorin gjuhë zyrtare. Për me mbërrit deri në këtë pikë neve na është dashtë shumë koordinim.

Tash nëse shohim çka më tutje, a kemi nevojë ende për mobilitete, shoqërisë civile ose ma mire tash ndoshta ka pak i kisha përmend edhe kontekstin se si kishin muajt me mirëmbajta ose si me realizu këtë të drejtë themelore brenda këtë pike.

Çka më tutje a nevojiten ende burimet që kemi ne si shoqëri civile, pra kemi burimeve financiare, kemi burime dhe edhe njerëzore, por edhe për organizatave të tjera të cilat janë ndërkombëtare. Këtë çështje që kemi dhe agjencitë zhvillimore për të gjitha hisedare tjerë, përveç komunës, të cilët merrnin forma për tjetër, kemi shty deri në këtë pikë.

A kemi nevojë ende me e shty? A kemi nevojë ende me përkrahë komunën? Edhe në çfarë forme kishe muajt me përkrahë me fonde ose me njerëz qe na i dedikojmë dhe e vendosën komunës për me kry punë të tjera. Kjo është diçka që e do shtosh ma kishe e orientuar kapak këtë bisedë.

Ndoshta diçka tjetër me shtu vetëm se pyetja është se si ta realizojmë tash e tutje këtë drejtësi të ushtrojnë ashtu si duhet. A ka komuna burime të mjaftueshme njerëzore për me realizu këtë drejtë që i bjen, a ka mjaft përkthyes që duhet me i përkthye dokumentet e nevojshme në gjuhën rome? Nëse s'ka a duhet ne prej OJQ-ve mi i paguan ata njerëz ose mi dediku ata njerëz prej radhëve tona atje, pra shohim se qysh kemi mbërri deri këtu nuk ka qenë kollaj, po hajt pe zëm se kemi bërë deri tash, çka më tutje edhe me e mbajt këtë drejtim.

Ne jemi të gatshëm prej hisedarë qe jemi te jashtëm për organizatat qeveritare, Në jemi të gatshëm e me kontribu vetëm të shohim se forma se si do të duhej ne angazhohem ato qe për me realizue drejtë për mirëmbajtje më thonë deri në ato momente ose deri në ato çaste ose deri në ato forca ku komuna është mjaft e fortë që me vazhdu veç.

Përshëndetjet e mia.

Me lejoni diçka konkretisht ndoshta do doja që komuna te jep një kontribut më efikas Lidhur me gjuhën rome. Unë jam me të vërtetë shumë e lumtur, këtë dua ta them gjithsesi që shumë me herët u ngrit zëri i komunitetit rom lidhur me zhvillimin e gjuhës rome dhe shumëçka tjetër.

Po meqë kaluan shumë vite te rëndësishme institucioni përkatës në komunën tone, është vetedijesu pra që me të vërtetë mjeti më i rëndësishëm i komunikimit për komunitetin rom është gjuha rome dhe zhvillimi i saj.

Pra për ta zhvilluar gjuhën rome dhe për ta ruajtur ne kemi nevojë ta përdorim apo jo duhet ta përdorim. Unë do doja konkretisht, pra kuot e rezervuar për krijimin e kuadrit të gjuhës rome, nje

romolog ose romologe, të cilën do të ishte mirë që të krijohet një skenë buxhetore që të financohet çdo vit, katedra për mësimin e gjuhës rome, pra për studime kemi në vendet e rajonit, kemi në Elbasan, kemi Maqedoni, në Kroaci edhe në Francë, sorbone kur është ke gjitha planprogramet që mundet një student me perfundu.

Ne kemi shkru shumë projekte, domethënë edhe institucioni përkatës, ministrja e arsimit, shkencës, teknologjisë dhe inovacionit, projektin për bursa apo institucioni ku unë punoj, nuk ka pas mjete të mjaftueshme dhe gjithmonë e kemi shty sot e nesër, sot e nesër nuk kemi pas edhe donatorë potencialë për ta mbështetur një student, i cili do të kishte kishte pas mundësi me pru pra një kulturë, një histori, një letërsi gjuhës rome, ku do të vazhdonte procesi i rritjes së numrit të studentëve.

Pra, kjo është me rëndësi nëse nuk kemi na kuadër, nëse s'kemi na njerëz të cilët kanë njohuri në këtë drejtim, atëherë nuk e di çka kishin bërë. Pse për gjuhën rome ka shumë punë për të bërë. Pastaj ju e dini që numri i komunitetit rom e gjithnjë përditë po zvogëlohet dhe ne nuk mundemi të arrijmë sipas ligjeve dhe nenligjeve që i ka komuna për t'ia arritur qëllimeve.

Ne që të jemi diku për shembull në asamble komunale, ne nuk nuk mundemi të arrijmë atë përqindje dhe nuk e di tash a do lidhet kjo temë që kërkesa ime me me qëllimin e gjuhës rome që ta kemi gjithashtu edhe nje kuot me një numër shumë të vogël zbritjes së përqindjes në mënyrë që të marrin pjesë dhe me 200 vota apo 300 vota po me 100 vota një përfaqësues i komunitetit rom për shkak se ne kemi gjuhëtar, pra kjo është ajo kërkesë.

Gjithashtu për krejt për çka thashë unë edhe për nevojat që i thotë secili sot këtu i deklaroi për zhvillimin dhe përdorimin e gjuhës rome, do të duhej të hartohet një strategji edhe formohet një grup punues që harton atë dokument, mu për gjuhën dhe letërsinë e gjuhës rome.

E kjo mundet me u forum në Prizren, për shkak se ka intelektualë romë, të cilët e kanë kry fakultetin e edukimit, por që e njohin shumë mirë gjuhën rome dhe munden me kontribu në këtë drejtim. Pra këto kërkesa nje kuot për romolog me kriju ni kuadër edhe skemën buxhetore. E pra kjo ishte ajo që unë them që është me rëndësi për ta futur që aty.

Albert Kinolli kryetar i partisë se romeve te bashkuar Kosovës

Unë sinqerisht dëshiroj të falënderoj të gjitha organizatat e joqeveritare, gjithë ata që kanë kontribu këtë kohën e fundit, që më në fund të realizohet një e drejtë e jonë elementare, një e drejtë kushtetuese nje e drejtë po e them edhe njëherë cilën na jep kushtetuta e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik i shtetit dhe ligji për përdorimin e gjuhës zyrtare Republikën e Kosovës.

Unë pajtohem me parafolësit jo që na është bërë një favor, mirëpo duhet përshëndetur vullneti i gjithë atyre zyrtarëve, ne krye me kryetarin e komunës e për vullnetin dhe angazhimin e tyre. Për shkak se kjo kërkesë daton që nga viti 2007, ku për fat keq deri tani nuk kemi hasur në mirëkuptim nga organet e nivelit lokal.

Mirëpo ja që tani më në fund, gjegjësisht në këtë mandat dhe ëndrra e shumë romëve është bërë realitet. Unë edhe njëherë dëshiroj të theksoj që sa për informimin tuaj sa për sigurimin e kuotes ne nivel lokal është e drejtë ekskluzive e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ligjit për zgjedhjet

në Republikën e Kosovës, për shkak se vendet e rezervuara ekzistojnë vetëm në Kuvend të Republikës Kosovës me kushtetutë, Republikës Kosovës.

Mirëpo, ne jemi krenarë për atë që kemi arrit sot dhe ju përgëzoj për punën të cilën e keni bërë, për shkak se me këtë plotësim ndryshim të rregullores, arrihet edhe deri te akti final dhe synimi që ne kemi pas shumë vite dhe këtë ëndërr, sepse po e bëjmë realitet për gjërat teknike.

Mendoj se pasojnë nga dita e sotme e më tutje, ku dhe angazhimi ynë direkt apo mënyrë indirekte siç nuk ka munguar gjer më tani nuk do të mungojë prapë. Jam i gatshëm që të marrin pjesë në çdo takim, në çdo nivel, me çdo strukturë, të japim kontributin tonë.

Dhe më në fund të gëzojmë drejtën si çdo komunitet tjetër në komunën e Prizrenit. Edhe njëherë dëshiroj nga këtu në emrin tim personal dhe ne emrin e subjektit të cilin e përfaqësoje, gjithë qytetarët, komunitetit rom, komuna e Prizrenit ti uroj për këtë punë të palodhshme të gjithë akterëve që kanë dhënë kontribut dhe mendoj se për gjëra tjera, rrjedhin më vonë do të jemi gjithë së bashku të një mendimi dhe ta finalizojnë këtë punë të madhe që u be kohen e fundi.

Ymer Korona, qytetarë nga lagjja e Jeta e Re

Përshëndetje, unë jam Ymer Korona, përndryshe jetojnë në lagjen Jeta e Re i përkas komunitetit rom. Në këto momente jam shumë i lumtur, po kjo lumturi na erdh falë kontributit individëve dhe organizatave jo qeveritare, partive po edhe organeve komunale së pari prej kryetarit për asamblesë komunale, individit komunal të gjithëve ju falënderoj sepse unë jam dhe jetoj dhe ekzistoj në qytetin e Prizrenit.

Edhe pse ne romët, nga historia i kemi pasur individ të cilët kanë kontribu në komunën e Prizrenit dhe edhe një herë ju falënderoj shumë. Të gjithë akterëve të cilët kanë marrë pjesë në këtë proces faleminderit.

Senad Ibishi, pjesë e organizatës zëri rom, ashkali dhe egjiptian

Të nderuar kryesues, të nderuar kolegë, zonja dhe zotërinj jam Senad Ibishi, pjesë e organizatës zëri rom ashkali dhe egjiptian. Definitivit unë personalisht ndjehem shumë i lumtur, shumë i gëzuar, por njëjtën kohë dhe i privilegjuar në lidhje me temën për te cilën po flasim.

Uroj dhe shpresoj që edhe komuna të tjera aty se ku është mundësia të marrin këtë format dhe të bëjnë të njëjtën gjë ashtu siç e ka bërë komuna e Prizrenit po njëherë dhe komunës së Prizrenit janë shtuar më shumë ngjyra, janë shtuar më shumë veçori, ku flitet për multikulturalizëm, për multi diversitet e kur bëhet fjalë për popullin romak, me kaq kulturë të begatë me kaq shumë se çka kanë të ofrojnë.

Padyshim që ndihem krenar dhe i lumtur në të njëjtën kohë. Çfarë duhet të theksoje është njëherë pajtohu me parafolësit të cilën e cakton që në secilin moment, ku shoqëria civile bashkohet drejt një kauze të denjë me një qëllim të vetëm, të realizohen të drejtat themelore të një komuniteti të caktuar.

Në këtë rast, komiteti rom ia del, ia del duke bashkëpunuar me shumë akterë, ia del duke konsumuar dhe duke shërbyer në forma dhe dimensione të ndryshëm. Komuna e Prizrenit është

fakt, kryetari më miqësor me romet është një çmim i ri, i cili ka ardh Komunës së Prizrenit definitivit si pasojë e punës së angazhimit, që është bërë kundrejt kauzës së përfshirjes së komunitetit rom në Komunën e Prizrenit. Njëherit, ju uroj punë të begatë. Ajo se çfarë mbetet për të bërë është në aspektin e implementimit kësaj rregullore, është shumë në aspektin e sigurimit, kuadro të cilët do punohet në këtë kauzë si shumë të rëndësishëm në punën dhe procesin në të cilin po kalojme.

Ju uroj sukses po njëherit edhe bashkëpunim të hapur komunës dhe gjithë akterëve të tjerë në kuadër të përfaqësimit që po i organizatës që janë pjesë e saj zerion ashkali dhe egjiptian.

Urma Menekshe – Mësimdhënëse e gjuhës rome

Jam Urma Menekshe, mësimdhënëse e gjuhës rome në komunën e Prizrenit. Njohja e gjuhës rome është shumë e rëndësishme edhe në nxitjen e mësimit të gjuhës rome, që po mbahet vetëm në komunën e Prizrenit, dhe ne, afër dhjetë vjet, po i mësojmë fëmijët romë për identitetin e tyre dhe gjuhën rome – gjuhën amtare.

Pyetja ime për juve, apo edhe mund të them si rekomandim, a mund të jetë që në ueb faqen e Komunës së Prizrenit, kur ka përkthime në gjuhë tjera, të kemi përkthime edhe në gjuhën rome për ata njerëz që nuk kuptojnë gjuhë tjetër dhe dëshirojnë të dinë më shumë se çfarë po ndodhë në Komunën e Prizrenit.

Në anën tjetër, kur kemi data të rëndësishme për komunitetin rom, apel për Drejtorinë e Arsimit, që të dinë se këto janë datat e komunitetit rom dhe ora e parë t'u dedikohet këtyre datave të rëndësishme për komunitetin rom.

Ju faleminderit, dhe, edhe një herë, ju faleminderit për aprovimin e gjuhës rome në Komunën e Prizrenit.

Fatmir Menekshe – OJQ “DURMISH ASLANO” dhe anëtarë i grupit punues për hartimin e rregullores

Faleminderit sapo informacion tash u informova nga zyrtari komunal se në webfaqen zyrtare të Komunës së Prizrenit është një rubrikë të veçantë ku aty tashmë kanë filluar me publikimin e dokumenteve, të cilët përkthehen nga përkthyesit që e kemi të angazhuar.

Besoj që dokumentet të cilat janë me interes më të madh, ato do të bëhen sa më shpejt, pastaj ngadalë e di që kemi punë me bo, po që e interesi ose dëshira e kryetarit është që më mbështet këtë proces deri në fund e do dikush tjetër fjalën.

Mustafa Balje – Qytetar nga komuniteti boshnjak

Jam Mustafa Balje, gazetar i Radio Televizionit të Kosovës, ndërsa sot flas në cilësi të qytetarit të Prizrenit. Keni bërë një punë të madhe. Fillimisht pjesëtarët e shoqërisë civile të komunitetit rom, faktori politik i cili ekziston tek komuniteti rom, ndoshta jo edhe aq ndikues në kuptimin politik, por shumë i rëndësishëm në plotësimin e të drejtave të tyre.

Gjithsesi e përkrah këtë ndryshim-plotësim të nenit që rregullon përdorimin e gjuhëve në Komunën e Prizrenit, por, bazuar në përvojën që kam duke përcjellë punën e Kuvendit Komunal të Prizrenit,

do të ballafaqohemi me një problem goxha të madhë, e ai është, përse ende nuk është formuar redaksia, apo redaksia gjuhësore në kuadër të Kuvendit Komunal të Prizrenit e cila e rregullon çështjen e përkthimeve të publikimit të dokumenteve në gjuhë të caktuara.

Konkretisht, ne ende nuk e kemi të punësuar ndonjë boshnjak në Zyrën e Shërbimeve të Përkthimit të dokumenteve. Kjo i jipet ndoshta ndonjë personi që as që është profesionist i asaj pune dhe vie deri tek një simbiozë e cila nuk ka asnjë lidhje me gjuhë.

Gjuha është një gjë e gjallë dhe fillimisht edukon njerëzit, përveç që informoni duhet edhe të edukojë. Nga ky aspekt, dua ta delegoj një kritikë apo ta nxisë qeverisjen aktuale komunale që të punojë në këtë çështje, sepse ne mund ta japim të drejtën e përdorimit të gjuhëve në përdorim zyrtar, por, duhet ta sigurojmë edhe përkrahjen adekuate edhe në aspektin financiar, duke i gjetur përkthyesit/lektorët e caktuar, dhe në anën tjetër të punësohen njerëz adekuat të cilët do të duheshin që në mënyrë adekuate ta bëjnë atë punë.

Pra, urimet e mia komunitetit rom në këtë arritje të madhe. Ky nuk është vetëm sukses i romëve por sukses i qytetit të Prizrenit i cili po e tregon fytyrën e tij të vërtetë, por, nga aspekti tjetër administrativ, dua ta inkurajoj Komunën që të punojë në këtë çështje sepse fatkeqësisht njëzetë vjet ende asgjë nuk është bërë, përveç në Kuvendin Komunal të qytetit, të punohet pak edhe në aspektin e përkthimit. Këtu ka njerëz që mund të ndihmojnë por duhet edhe vullneti i mirë i komunitetit shumicë shqiptar.

Përshëndetje të gjithëve i falënderoj të gjithë për kontributin e tyre që e kemi arrite me be një punë, për të cilën do flitet në vitet e vijueshme.

Fatmir Menekshe – OJQ “DURMISH ASLANO”

Nëse dikush tjetër nuk ka të pyes apo të thotë diçka, unë do i thoja fjalët e mia të fundit. Ju faleminderit edhe një herë për kontributin dhe aktivizimin që e keni treguar në mënyrë të vazhdueshme. Për romët dhe çështjen rome, për të drejtat rome dhe për gjuhën rome ende nuk ka marr fund e gjitha. Tani, prej nesh pritet që të jemi të bashkuar, të mobilizohemi.

Deri më sot kemi parashtruar kërkesa ndërsa prej sot duhet të bëjmë edhe ankesa, që nëse ndonjëri prej nesh kërkojnë ndonjë dokument në gjuhën rome dhe nuk i ofrohet. Prej tani, duhet ta luajmë rolin e monitoruesve të shohim se gjithçka që është në letër si Vendimet apo Rregulloret a do të zbatohen apo jo.

Nëse nuk zbatohen, unë kërkoj prej të gjithëve që të jeni veshët dhe sytë tanë, t'i adresojmë këto çështje në mënyrë që në t'i bëjmë ankesat tona. Tani ekziston obligimi për zbatim dhe praktikim të asaj çfarë ne kërkojmë, në aspektin e përkthimit të dokumenteve.

Gjithsesi, duhet ditur se gjuha në përdorim zyrtar do të thotë se jo secili dokument duhet përkthyer, por nëse ka kërkesa nga komuniteti, atëherë ata (komuna) obligohen ta bëjnë përkthimin, sikurse është treguar nga shembulli i dhënë nga zyrtari ligjor i Komunës së Prizrenit.

Perveq kësaj, i inkurajoj të gjithë romët që të kërkojnë, të përdorin dhe të lexojnë. Një shembull ndoshta negativ që mund ta cekë është se Komuna e Prizrenit tani ka disa dokumente në gjuhën rome, por shumica prej nesh nuk i kemi ditur/lexuar.

Tani e tutje edhe ne duhet ta promovojmë këtë më shumë dhe t'i vetëdijësojmë familjet tona, aktivistët që ta përdorin gjuhën rome sepse e gjithë puna jonë ndërlidhet nga rezultatet që marrim nga qytetarët. Nëse nuk do të ketë asnjë kërkesë nga komuniteti apo nga vetë ne, atëherë edhe ata nuk obligohen që ta përkthejnë dokumentin.

Ne fund, të ju tregoj se Rrjeti ad-hoc, e ka bërë një listë, i ka renditur dokumentet të cilat duhen përkthyer, dhe presim përkthimin e këtyre dokumenteve. Normalisht, nëse ndërkohë ka ndonjë kërkesë nga komuniteti, ju inkurajoj të gjithëve t'i adresoni. Edhe një herë, ju faleminderit të gjithëve.

Osman Osmani – OJQ “NEVO KONCEPTI”

Ju faleminderit. Unë vetëm deshta edhe një mendim në fund, kjo le të jetë si përfundim. Qëllimi ynë, kur kemi filluar të merremi me këtë punë, nuk ka qenë që t'i sjellim vështirësi/barrë Komunës. Ta sjellim në një situatë të pakëndshme.

Qëllimi ynë ka qenë ta plotësojmë të drejtën tonë dhe paralelisht me këtë ta lehtësojmë realizimin e e asaj çka Kushtetuta, Ligjet dhe Rregulloret japin të drejtë të realizimit. Ne, në vitin 2018 ia kemi dhënë një letër Komunës duke shprehur gatishmërinë që të përkrahim edhe në mënyrë vullnetare, pa pagesë, gjithçka që i duhet Komunës, çka është në interes të saj dhe të komunitetit rom, të përkthejmë pa pagesë në gjuhën rome.

Ne, e dimë që tani ju e keni personin i cili bënë përkthimin, por shoqëria civile ende mbetet mbrapa këtij vendimi që ne jemi të gatshëm që ta lehtësojmë këtë proces. Atë që e përmendi Fatmiri, ne e kemi për obligim ta informojmë komunitetin rom që e drejta jonë është plotësuar dhe tani ne duhet t'i vetëdijësojmë se si ta realizojnë atë të drejtë. Nuk duam që t'i sjellim barrë Komunës. Kjo është gjëja e fundit që do dëshironim. Ju faleminderit

Haziz Krasniqi

Atëherë, nëse veç nuk ka folës të paraqitur, ju falënderoj për pjesëmarrjen, shihemi ne takimet të radhës.

Konsultimi ka përfunduar në orën 10:45.

Me 25.04.2024, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/u-mbajt-konsultim-publik-per-plotesim-ndryshimin-e-projekt-rregullores-per-perdorimin-e-gjuheve-ne-komunen-e-prizrenit/>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/YLEaimjfcpcpKYaTn/?mibextid=oFDknk>

Procesmbajtës:

Haziz Krasniqi

